

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep:	Nr. Prot:
Dep:	Br. Prot:
Dep: <i>PKK/DP</i>	Prot. No: <i>03/4628/12</i>
Nr. Itaq:	Em:
Em. sh. an. ca:	Datum:
Nr. pages:	Data: <i>14.12.12</i>

*Agjenc.
AntiKORUP*

GJL. Nr.1271/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Dalip Bega dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. Juridike Sanije Salihu, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Perparim Krasniqi nga Rahoveci, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prizren, Regj.I.nr.447/05/2012 të dt. 20.06.2012, në bazë të nenit 31, al.3,39 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 23.11.2012, mori

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**

ABROGOHET aktvendimi i goditur dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prizren, me aktvendimin Regj.I.nr.447/05/2012 të dt. 22.06.2012, ka shpallë përgjegjës të pandehurin Perparim Krasniqi nga Rahoveci, sepse si zyrtar i lartë publik nuk ka bërë në afatin e rregullt ligjor, deklarin e rregullt vjetor të pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, sipas kërkesës së AKK-gjegjesisht nuk ka përmbushur obligimin e tij ligjor për deklarin e pasurisë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, me ç'veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 7, neni 6,5 e lidhur me nenin 17 al.1 par.1.2 të Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtar dhe me aplikimin e nenit 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet, të pandehurit i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 500 Euro. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Përparim Krasniqi, ka paraqitur ankesë, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale dhe vendimit mbi dënimin, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Thekson se pa fajin e tij ka ardhur deri te vonesa për deklarin e pasurisë dhe pa të drejtë është shpallur fajtor, andaj ka propozuar që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ose të ndryshohet e ai të lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi i shqiptuar.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklarin e dhënë të pandehurit në seancën e shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt. 20.03.2012, deklarin e dëshmitarit Enis Sadiku zyrtar i lartë i Anti Korrupsionit, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

Kolegji vlerëson se dispozitivi i aktvendimit të goditur është në kundërshtim me nenin 205 të Ligjit mbi kundërvajtjet, respektivisht gjykata e shkallës së parë bënë përshkrimin e veprimit inkriminues të cilin veprim e kryen i pandehuri, se nuk ka bërë në afatin e rregullt ligjor deklarin e rregullt vjetor të pasurisë, sipas kërkesës të AKK-së, dhe nuk e

2.

ka përmbushur obligimin e tij ligjor për deklarimin e pasurisë brenda fatit ligjor prej 30 ditësh dhe të gjitha këto veprime i cilëson me dispozitë nga neni 7 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik, e cila parasheh deklarimin me rastin e marrjes së detyrës së zyrtarit të lartë publik, dhe neni 6 që parasheh deklarimin sipas Ligjit si dhe nenin 5 të të njëjtit Ligj nr.04/L-50 dhe për këtë kundërvajtje me aplikimin e nenit 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet gjykata e shkallës së parë e dënon me gjobë në shumë prej 500 Euro.

Kolegji vlerëson se si pasojë e mos vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendim ku dispozitivi është i pa qartë dhe konfuz, se përshkruan deklarimin e rregullt vjetor, sipas detyrës zyrtare dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, që janë disa lloje, derisa kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse është vetëm për nenin 7 të Ligjit nr.04/L-050, kurse nga prova e bashkangjitur kësaj kërkesë si dëshmi shifet se anëtari i ri i Kompanisë regjionale për mbeturina "Ekoregjioni" SH.A.në Prizren, është emëruar më dt.01.06.2011, që sipas Ligjit në fuqi në këtë kohë ka pasur afat 60 ditë për deklarimin e pasurisë (Ligji nr.03/L-151) i cili fakt nuk është konstatuar dhe vërtetuar saktë, që gjykata të aplikoi dispozitat ligjore të Ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së kundërvajtjes i cili është më i favorshëm për të pandehurin. Meqë Ligji nr.04/L-050 është shpallur më dt.31.08.2011 dhe ka dispozita ndëshkimore më të ashpëra. Andaj aktvendimi si i tillë nuk mund të qëndroj dhe për këto arsye është abroguar që në plotësim procedure gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në vërejtjet e lartcekura, duhet konkretisht të konstatoi se kur është njoftuar i pandehuri për deklarimin e pasurisë dhe për cilin lloj, se çfarë kundërvajtje ka kryer i pandehuri dhe me çfarë dispozite ndëshkimore një veprim i tillë është i përcaktuar duke pas parasysh kohën e kryerjes së kundërvajtjes dhe pastaj të nxjerrë aktvendim të ri e të bazuar në Ligj.

Më sa u tha më lartë konform nenit 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
GJL. Nr. 1271/2012 të dt. 23.11.2012.

SEK. JURIDIKE
Sanije Salihu

KRYETARI I KOLEGJIT,
Ramiz Knaqi